

Takim i ekipës për menaxhim të projektit për zvogëlim të pagesave në para të gatshme në Kosovë

**Ekipi menaxhues i projektit në kuadër të Këshillit Kombëtar të
Pagesave (KKP)**

Përgatitur nga: Departamenti i Sistemeve të Pagesave në BQK

5 Shtator, 2013

- Miratimi i procesverbalit dhe konkluzioneve të takimit të fundit (22 Shkurt 2013)
- Informim i përgjithshëm nga grupet punuese të BQK-së dhe bankave komerciale, dhe aktiviteteteve lidhur me grupin menaxhues të projektit për reduktim të transaksioneve me para të gatshme;
- Statistika për instrumentet dhe shërbimet e pagesave
 - Kosova krahasuar me vendet në Evropën Qendrore dhe Juglindore
- Informim lidhur me Mastercard dhe Visa
- Hapat e ardhshëm;

1. Miratimi i procesverbalit dhe konkluzioneve të takimit të fundit (22 Shkurt 2013)

1. Me VISA do të konkretizohet asistenca, është menduar që kjo asistencë të jetë në drejtim të edukimit/kampanjës për reduktim të parasë së gatshme dhe përdorim të pagesave elektronike. Nga MasterCard, përkrahet vazhdimi i bashkëpunimit pa kosto për përkrahje edhe në fusha specifike (anën rregullative, operacionale, apo tjetër) nëse pajtohemi bashkë me kompanitë në fjalë gjatë diskutimeve në vazhdim. Planifikim të buxhetit për këtë qëllim mund të ketë në fazat e mëvonshme për punë konkrete. (BQK dhe ekipi tanimë janë në vazhden e aktiviteteve, analiza e tregut, analiza financiare etj.)

- Në proces

2. Deri me 11 Mars, 2013 të përgatitet dhe të dërgohet në “paymetnsystems@bqk-kos.org” drafti i kërkesave/nevojave për asistencë nga VISA (nga bankat: PCB, RBKO, NLB, TEB, gjersa BEK, ka njoftuar në BQK, të tjerat banka (BpB, BKT, etj) dhe kompanitë e institucionet do të kontaktohen përsëri nga BQK-ja. Anëtarët e grupit punues për zvogëlim të pagesave në para të gatshme të përgjigjen në e-mailin paraprak (dërguar nga BQK me 13 Shkurt 2013)

- Në proces

3. Nëngrupi i Shtyllës së III të përgatis dhe të dërgojë analizën mbi Qendrën Procesuese Ndërbankare (teknike, funksionale, financiare) deri në Prill, 2013

- *Është finalizuar nga BQK e mbështetur nga materialet informuese dhe diskutimet me banka komerciale*

4. BQK të organizon takimin me banka dhe kompani të shërbimeve publike për procedim të mëtejshëm dhe diskutim rreth nënshkrimit të autorizimit tek bankat

- **Është mbajtur, janë udhëzuar bankat dhe kompanitë dhe është përshtatur udhëzimi i skemës së Debitimit Direkt**

5. Takimi i ardhshëm do të mbahet në pjesën e parë të Korrikut, 2013 d.m.th. pas sigurimit të mbështetjes së kompanive me përvojë (Master Card dhe Visa) për kushtet dhe mënyrën e asistencës së tyre, pa shpenzime gjatë kësaj faze fillestare. Pas diskutimeve me Bankën Botërore, për asistencë në kuadër të shtyllës III dhe gjithashtu pas finalizimit të raportit statistikor krahasues.

2. Informim i përgjithshëm nga grupet punuese të BQK-së dhe bankave komerciale, dhe aktiviteteteve lidhur me grupin menaxhues të projektit për reduktim të transaksioneve me para të gatshme

- Analizë për krijimin e qendrës procesuese të kartelave në Kosovë (ana teknike, funksionale, financiare etj.) (shtojca 1);
- Analizë mbi Përdorimin e Instrumenteve të Pagesave dhe raporte statistikore mbi instrumentet dhe terminallet e pagesave (<http://www.bqk-kos.org/?cid=1,59,54>);
- Analizë mbi skemën Kos Giro dhe Debitimin Direkt;
- Takime me banka dhe kompani pjesëmarrëse dhe jo pjesëmarrëse në skemat Kos Giro dhe Debitim Direkt

3. Instrumentet dhe терминаlet e pagesave- Kosova krahasuar me vendet në Evropën Qendrore dhe Juglindore (1)

Tab 1. Tabela krahasuese e numrit të terminaleve dhe instrumenteve të pagesave në vitin 2012

Përshkrimi	Banorë	Sipërfaqja (km ²)	Densiteti (për km ²)	ATM	për 1 milion banorë	për 100 km ²	POS	për 1 milion banorë	për 100 km ²	Kredit Kartelat	për 1 milion banorë	Debit Kartelat	për 1 milion banorë	E-Banking
Kosova	1.8	10,887	177	483	268	4	8,592	4,773	79	95,942	53,301	599,651	333,139	97,089
Shqipëria	2.8	28,748	97	823	294	3	5,307	1,895	18	49,173	17,562	719,809	257,075	54,926
Bosnia	3.77	51,197	74	1,284	341	3	19,320	5,125	38	202,866	53,811	1,513,818	401,543	94,399
Serbia	7.12	77,474	92	2,785	391	4	62,656	8,800	81	951,614	133,654	4,875,796	684,803	-
Kroacia	4.28	56,594	76	4,083	954	7	90,433	21,129	160	1,872,949	437,605	6,664,654	1,557,162	1,368,975
Maqedonia	2.08	25,713	81	852	410	3	33,267	15,994	129	295,815	142,219	1,156,562	556,039	389,772

Kosova vazhdon të ketë trendin më të lartë të rritjes së numrit të instrumenteve dhe terminaleve të pagesave, dhe kjo ka rezultuar që sot Kosova të jetë afër mesatares së vendeve në regjion sa i përket instrumenteve dhe terminaleve të pagesave

Tab 2. Tabela krahasuese e numrit dhe vlerës së transaksioneve me kartela në vitin 2012

Shteti	Numri i transaksioneve me kartela (në milion)	Vlera e transaksioneve me kartela (në miliard euro)	Mesatarja e transaksioneve me një kartelë
Kosova	12.43	108	17.87
Shqipëria	1.11	0.10	1.44
Maqedonia	37.21	1.93	25.62
Kroacia	292.74	14.56	34.29
Bosnia dhe Herz.	60.28	3.24	35.12
Serbia	14162	5.04	24.30

3. Instrumentet dhe terminalet e pagesave- Kosova krahasuar me vendet në Evropën Qendrore dhe Juglindore (2)

Fig 1. Norma e rritjes së numrit të terminaleve ATM




Fig 2. Norma e rritjes së numrit të terminaleve POS




Fig 3. Norma e rritjes së numrit të kartelave të kreditit






Fig 4. Norma e rritjes së numrit të kartelave të debitit



3. Instrumentet dhe terminallet e pagesave- Kosova krahasuar me vendet në Evropën Qendrore dhe Juglindore

Fig 5. Numri I llogarive të aksesueshme nga interneti



Lidhur me përdorimin e shërbimit e-banking, numri i transaksioneve në vitin 2012 ka qenë 626,762 transaksione, ndërsa vlera 1,499,093,438.23 €. Nëse këto të dhëna i krahasojmë me ato të vitit 2011, do të konstatohet rritje e numrit të transaksioneve përmes e-banking për 47.7%, dhe rritje të vlerës së këtyre transaksioneve rreth 23.1%.

4. Informim lidhur me Mastercard dhe Visa

5. Hapat e ardhshëm

Faleminderit

<http://www.bqk-kos.org/?cid=1,59,55>